



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.03.2021, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtim i dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11 981, datë, 26.02.2021 “Për kthimin e ligjit nr. 15/2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Antoneta Dhima, Elona Hoxha Gjebrea, Artemis Dralo Malo, Sadi Vorpsi, Edmond Rrushi, Edmond Stojku, Arben Elezi, Ylli Shehu, Nimet Musaj, Elena Xhina dhe Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Alban Zeneli, Paulin Sterkaj, Anduel Xhindi, Luan Duzha, Myslim Murrizi, Luan Harusha dhe Lefter Maliqi.

Të ftuar:

Petro Koçi – Zëvendësministër i Mbrojtjes

Ismail Shehu – Drejtor Juridik në Ministrinë e Mbrojtjes

Bilbil Bitri – Drejtor i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë

Bledar Dervishaj – Këshilltar i Presidentit për Çështjet Ligjore

Dedë Prenga – Këshilltar i Presidentit për Mbrojtjen

Ketrin Treska – Drejtoreshë e Përgjithshme e Shërbimeve Juridike në Presidencë

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëdita!

Mund t’ju duket njoftimi pak në kohë të shpejtë, por kalendari i punës së Kuvendit, njëkohësisht, edhe Rregullorja e Kuvendit na detyrojnë që dekretin e Presidentit të Republikës ta marrim në shqyrtim në mbledhjen më të parë. Kështu që kjo është mbledhja që ne mund të bëjmë përpara seancës plenare të së martës së Kuvendit të Shqipërisë.

Sot në rendin e ditës së mbledhjes kemi shqyrtimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11 981, datë 26.02.2021, “Për kthimin e ligjit nr. 15/2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”. Pra, sikundër jemi të gjithë të informuar, në Komisionin e Sigurisë Kombëtare janë shqyrtuar disa shtesa dhe ndryshime të propozuara në ligjin “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura në Republikën e Shqipërisë”. Ky ligj është miratuar në Kuvendin e Shqipërisë, ndërkohë që Presidenti i Republikës ka ushtruar të drejtën e vetos në rastin konkret, duke e kthyer ligjin për rishqyrtim në Kuvendin e Shqipërisë.

Të ftuar për të prezantuar dekretin, njëkohësisht, edhe argumentet kundër dekretit të Presidentit të Republikës, kemi zëvendësministrin e Mbrojtjes, zotin Petro Koçi, zotin Ismail Shehu, drejtor Juridik, kolonel Bilbil Bitrin. Faleminderit! Nga institucioni i Presidentit të Republikës kemi të ftuar zotin Bledar Dervishaj, këshilltar i Presidentit për Çështjet Ligjore, zotin Dedë Prenga, këshilltar i Presidentit për Mbrojtjen, dhe zonjën Ketrin Treska, drejtoreshë e Përgjithshme e Shërbimeve Juridike në Presidencë.

Relatore nga ana e Komisionit të Sigurisë Kombëtare për këtë mbledhje do të jetë zonja Dhima që, njëkohësisht, ka qenë edhe relatore e ndryshimeve të propozuara në ligjin “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura në Republikën e Shqipërisë”. Pa humbur kohë, unë do t’ia kaloj fjalën përfaqësuesit të institucionit të Presidentit të Republikës.

Cili nga të ftuarit e dëshiron fjalën?

Zoti Dervishaj, keni fjalën për të bërë një prezantim të arsyeve për kthimin e ligjit në fjalë.

Bledar Dervishaj – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar anëtarë, po bëj një përmbledhje të arsyeve të dekretit, edhe për ekonomi të kohës suaj.

Ashtu siç ju e thatë, Kuvendi ka miratuar, ndër të tjera, edhe ligjin nr. 15/2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Para se gjithash, Presidenti e ka cituar në arsyetimin tij se mbështet çdo ndryshim ligjor, që është në përputhje me Kushtetutën dhe që realisht shkon në funksion të përmbushjeve të qëllimeve të vet ligjit bazë dhe nuk i cenon ato. Sipas praktikës parlamentare të konstatuar nga ana jonë, rezulton se projektligji në fjalë nuk është konsultuar plotësisht as me ushtarakët, por as me Presidentin e Republikës, i cili, përveçse President, është edhe Komandat i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura. E citoj këtë fakt, për arsye se ky ligj është bërë objekti debati në Gjykatën Kushtetuese, e cila me vendimin nr. 64/2015 veç të tjerash ka përmendur në arsyetimin e saj edhe faktin se si rregull konsultimi projektligji me organet që përfshihen ose preken nga fusha e rregullimit të tij është pjesë e procesit legjislativ. Në këto kushte, përderisa Presidenti i Republikës, të cilit Kushtetuta i ka njohur disa funksione si në procesin legjislativ, atë të Komandantit të Përgjithshëm në Forcat e Armatosura dhe me disa tagra të tjerë në dhënien e gradave madhore apo në emërimin e drejtuesve të lartë të forcave tokësore, detare apo ajrore, ishte e detyrueshme që Ministria e Mbrojtjes, përpara se të ndërmernte nismën, duhej që këtë projektligj të konsultonte edhe me Presidentin e Republikës së institucionit. Kjo gjë nuk ka ndodhur, megjithatë tashmë jepet mundësia dhe Presidenti e shfrytëzoi atë që ta kthente ligjin, duke përcjellë njëkohësisht disa mesazhe të qarta për Kuvendin, por edhe propozuesit, pra Këshillin e Ministrave dhe Ministrinë e Mbrojtjes.

Në themel, ky ligj, nëse do të hyjë në fuqi me përmbajtjen e miratuar në seancën plenare dhe dekreti i Presidentit do të rrëzohet, pra nuk do të merret parasysh, do të sjellë një impakt negativ në drejtimin strategjik dhe operacional të Forcave të Armatosura. Kjo është thënë në arsyetimin e Presidentit, pasi ligji synon të ulë nivelin e arsimit të kërkuar të shtetasve për t'u përfshirë në Forcat e Armatosura. Deri më sot është kërkuar si kriter i domosdoshëm ligjor përfundimi i arsimit parauniversitar, pra i shkollës së mesme, tani përmes këtij ligji synohet që të lejohet hyrja në Forcat e Armatosura edhe atyre shtetasve që kanë përfunduar vetëm arsimin 9-vjeçar. Në vlerësim të Presidentit për një vend anëtar në NATO-s, kjo gjë nuk është e përshtatshme dhe Shqipëria nuk duhej të shkonte drejt një zgjidhje të tillë, duke çeduar në vetvete kërkesat për nivelin arsimor të domosdoshëm që duhet të përmbushë një kandidat, me qëllim rritjen e cilësisë së përbërjes në Forcat e Armatosura. Për më tepër, një politikë e tillë rekrutimi nuk shkon as në përputhje me vetë politikën që duhet të ndjekë vendi për nxitjen e brezave të rinj dhe përcjell mesazhin më të gabuar se, edhe pa përfunduar arsimin parauniversitar, mund të punësohen dhe aq më pak në sistemin ushtarak. Në arsyetimin e tij Presidenti ka sjellë në vëmendje të Kuvendit dhe të qeverisë faktin se ligjvënësi së bashku me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura duhej të kishin bërë një analizë të thelluar për të vlerësuar realisht cilat janë arsyet e vërteta të mungesës së

vullnetit të të rinjve apo të të rejave shqiptare për t'iu bashkuar Forcave të Armatosura dhe për të adresuar pikërisht këto çështje për zgjidhje. Është më se e qartë se mosshprehja e vullnetit për të qenë pjesë e Forcave të Armatosura nuk lidhet me mungesën e kontingjenteve të këtij brezi me arsimim parauniversitar, pasi Shqipëria ka një numër të lartë të të rinjve për të plotësuar edhe nevojat e pakta për rekrutim që kanë Forcat e Armatosura Shqiptare në një vit kalendarik, jo vetëm me arsim parauniversitar, por edhe me arsim të lartë ka të rinj plot. Arsytet janë krejt tjera, pasi për rekrutim në Policinë e Shtetit numri i kandidatëve është disa herë më i lartë se numri i vendeve vakante të hapura për konkurrin, ndërsa për t'u bërë pjesë e Forcave të Armatosura paraqiten si kandidatë një numër që përkon me përafërsisht 70% të nevojave. Problematika nuk qëndron te kriteri i arsimit dhe as nuk mund të konsiderohet i fortë, por, përveç arsyeve të tjera që Presidenti i Republikës i ka cituar në dekret, por edhe në mesazhet e tij publike, këto problematika lidhen drejtpërdrejtë edhe me mënyrën e trajtimit të ushtarakut, përfshirë trajtimin financiar, që ka çuar në largimin në masë nga radhët e Forcave të Armatosura të të rinjve dhe të rejave me arsim të lartë dhe trajnime brenda dhe jashtë vendit.

Në asnjë lloj përvoje vendase apo të huaj nuk evidentohet se rritja e nivelit të përgatitjes së trupës ushtarake profesioniste shkon paralel me uljen e nivelit arsimor për rekrutimet e reja. Kjo zgjidhje e menduar nga Ministria e Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave dhe e miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë është e papranueshme nga Presidenti i Republikës, si Komandat i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura. Kjo zgjidhje, duke ulur nivelin e arsimit të kërkuar, çon në: cenimin direkt të nivelit të përgatitjes së trupës, që, pavarësisht trajnimeve, rrezikon të mbetet larg një trupe profesioniste; në cënimin e nivelit të ndërveprueshmërisë me strukturat ushtarake të vendeve aleate e mike, me të cilat do të trajnohen e përgatiten kontingjentet e rinj; dëmtimin e karrierës ushtarake, duke bërë ndërprerjen në mënyrë të padrejtë të vazhdimit të karrierës, pasi ushtari për t'u titulluar nënoficer duhet të ketë arsimin parauniversitar. Kjo normë, që tentohet të hyjë në fuqi, do të ketë impakt direkt në qëndrueshmërinë e Forcave të Armatosura, pasi subjektet të cilat do të rekrutohen dhe nuk mund të kenë më ecure në karrierë, për shkak të mungesës së arsimit, do të duhet të largohen nga radhët e Forcave të Armatosura. Lejimi i hyrjes në këto forca dhe, për pasojë, dalja më shpejt, çon në investimin afatshkurtër të shtetit në këto shtetas, që për shkak të mungesës së arsimit dhe kërkesave që ka legjislacioni për marrjen e gradave të radhës do të duhet të dalin shpejt nga të qënurit aktivë në Forcat e Armatosura. Shqipëria, në këto kushte, nuk e ka luksin të rekrutojë ushtarë dhe të investojë në trajnimin e tyre për një afat kohor kaq të shkurtër, duke mosgarantuar qëndrueshmërinë dhe vijueshmërinë e karrierës së tyre. Kjo zgjidhje është tregues i mungesës së vizionit në drejtimin e Forcave të Armatosura dhe një masë, që në terma afatgjatë, do të çojë në uljen e imazhit dhe

kredibilitetit të tyre. Kjo do të sjellë pasoja edhe më të rënda, duke vendosur në pikëpyetje edhe bashkëpunimin dhe ndërveprimin e partnerëve, që duke parë përbërjen dhe nivelin e trupës sonë ushtarake bazë, nën atë që është e pranueshme për ta, do të hezitojnë gjithmonë e më shumë të shtojnë bashkëpunimin, apo të ofrojnë mbështetjen që deri më tani nuk ka munguar.

Ky projektligj është një hap mbrapa në procesin e reformimit dhe përmirësimit të trupës sonë ushtarake profesioniste.

Presidenti ka vënë theksin te fakti se arsimim-kualifikimi është baza e përparimit në gradë e hierarki, është baza e dijes dhe zhvillimit. Këtu nuk kanë sesi të bëjnë përjashtim Forcat e Armatosura.

Nga ana tjetër, ligji...

Petro Koçi – Zonja kryetare, a duhet të dëgjojmë fjalimin e këtij gjithë ditën?! Ka katër që po flet për çështjen e rekrutimit me të rinjtë që janë me formim 9-vjecar.

Bledar Dervishaj- Zoti Koci, ju nuk duhet të merrni pjesë fare në shqyrtimin e dekretit.

Petro Koçi – Ju lutem shumë, sepse kohën që kemi në dispozicion duhet ta shfrytëzojmë me rendiment! Nuk mund të dëgjomë fjalime elektorale nga Presidenca.

Ermonela Felaj- Zoti Koci, ju lutem!

Bledar Dervishaj- E nderuara zonja kryetare...

Ermonela Felaj- Zoti Dervishaj, mund ta vazhdoni fjalën tuaj,

Bledar Dervishaj- Këtu po shqyrtohet dekreti dhe jo ligji. Në qoftë se nuk duhet të flas unë për dekretin, kush duhet të flasë?!

Ermonela Felaj- Zoti Dervishaj, unë ju kam dhënë fjalën për të folur për dekretin, duke ju kërkuar që të flisni përmbledhtas meqenëse argumentet janë të shkruara.

Bledar Dervishaj- Për t'ia përsëritur përfaqësuesit të qeverisë. Është shkelur Kushtetutën dhe nuk është konsultuar ky projektligj me Presidentin e Republikës dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

Aktualisht, ligji përcakton 3 kritere bazë për përparimin në gradë, të cilat i dinë mirë Ministria e Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave dhe të gjithë. Ato janë: arsimim-kualifikimi; vlerësimi vjetor dhe kohëqëndrimi në gradë. Përmes ndryshimeve ligjore hiqet nga përcaktimi në ligj i kriterëve të domosdoshme për përparimin në gradë, dhe duke lejuar caktimin e tyre me një akt ministri. Ky ndryshim bie ndesh me nenin 118 të Kushtetutës dhe çon në një cenim të padrejtë e të papranueshëm të garantimit të ecurisë në karrierën e ushtarakëve në Forcat e Armatosura dhe, për pasojë cenon vetë thelbin e ligjit nr. 59/2014.

Forcat e Armatosura qëndrojnë e mbështeten fuqishëm në dy shtylla kryesore: karrierë dhe hierarki e drejtimit. Duke cenuar njërin nga këto dy shtylla bazë, siç bëhet përmes këtij

parashikimi në ligj, janë cenuar automatikisht dhe drejtpërdrejt, me pasoja të pariparueshme, Forcat e Armatosura.

Presidenti i Republikës, në arsyetimin e tij, ka ngritur një pyetje për përfaqësuesit e qeverisë dhe të Kuvendit. I kujt është interesi që trupa jonë ushtarake bazë e Forcave të Armatosura të cenohet dhe të humbasë kredibilitetin e saj?

Presidenti, në arsyetimin e tij, ka shkruar se është i prirur të besojë se kjo është pasojë e mungesës së vizionit, e zgjidhjeve afatshkurtra dhe vlerësimit të cekët, gjë e cila duhet riparuar.

Një shkak tjetër i arsyetimit është fakti se ligji i miratuar rrezikon të çojë në cenim të karrierës ushtarake dhe piramidës së drejtimit në Forcat e Armatosura.

Ndryshimet në ligj sjellin pasiguri të theksuar në qëndrimin në detyrë të ushtarakut dhe kjo për dy arsye:

Së pari, nuk ekziston më emërimi në një funksion me gradë më të ulët, vetëm në rast riorganizimi strukturor dhe mungese funksioni organik, por mundëson emërimin në një funksion me gradë më të ulët të ushtarakut në çdo rast dhe pa asnjë kriter.

Së dyti, heq pëlqimin e ushtarakut për emërimin në një funksion me një gradë më të ulët, që ka qenë kriter kryesor për çdo lëvizje të tillë edhe në rastet e mungesës së funksionit organik.

Të dyja këto ndryshime e vënë ushtarakun në një pozitë aspak të favorshme, cenojnë ecurinë në karrierën ushtarake në mënyrën më të rëndë të mundshme, duke i bërë ushtarakët të lëvizshëm në funksione që nuk përputhen me gradën që mbajnë, ndërkohë që nuk përputhet as me vullnetin e tyre.

E nderuar zonja kryetare,

Për ta përmbyllur fjalën time, që u duk si fjalim, ndryshimet ligjore janë bërë në mënyrë të nxituar; pa oponencë dhe pa ekspertizën e ushtarakëve, të cilët prekën drejtpërsëdrejti nga ligji; pa vizion për të ardhmen e Forcave të Armatosura të një vendi anëtar të NATO-s; pa u konsultuar me institucionet e përfshira në këtë proces dhe me misionet e ekspertizës ushtarake që asistojnë Shqipërinë.

Presidenti ka vënë theksin se ky ligj e cenon kredibilitetin e forcave ushtarake si një vend anëtar i NATO-s. Për të gjitha sa unë përmbloodha më sipër dhe çfarë është parashikuar në dekret, ligji bie ndesh me parimet kushtetuese të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, të sigurisë juridike dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese. Prandaj, Presidenti me dekretin e tij të datës 26 shkurt ka vendosur kthimin për rishqyrtim, me qëllim rishikimin e neneve 6, 9, 10, dhe 15 të tij.

Në qoftë se më lejon, zonja kryetare, unë këtë e kam për vete, e njoh mirë ushtrinë e personalisht, si djalë ushtaraku dhe me një familje me një bazë shumë të gjerë ushtaraku. Këtë e kisha për përfaqësuesin e qeverisë.

Mirupafshim!

Në linjë do të qëndrojë zonja Treska, për arsye se unë do të jem në një mbledhje tjetër.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Dervishaj!

Shpresoj që të gjithë pjesëmarrësit në këtë mbledhje të kenë durimin për të dëgjuar argumentet dhe kundërargumentet në lidhje me ndryshimet e propozuara në ligjin “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”. Përtej çdo diskutimi politik, të mos harrojmë se ligji ka impakt të gjerë, në fakt, e gjitha Forca e Armatosur është e interesuar për përmbajtjen e ligjit dhe ndryshimet që diskutohen për të. Kështu që le t'i mëshojmë argumentit ligjor, argumentit juridik në këtë debat.

Fjala për përfaqësuesin e Ministrisë së Mbrojtjes, zëvendësministrin e Mbrojtjes, zotin Koçi. Më pas fjala do të jetë për zonjën Dhima.

Petro Koçi – Faleminderit, zonja kryetare!

Së pari, më lejoni të them se ligji, që ka kaluar në parlament, pavarësisht se nuk është aprovuar nga Presidenti i Republikës, sjell një sërë risish në mënyrën se si trajtohet karriera e ushtarakut në Forcat tona të Armatosura, që janë përgjithësisht ndryshime, të cilat janë mirëpritur në masën e gjerë të ushtarakëve të të gjitha gradave. Unë personalisht jam marrë disa kohë me këto çështje dhe e kam trajtuar në mënyrë ezauruese ligjin, ndaj jam shumë i kënaqur që më në fund erdhi momenti që ta sillnim projektligjin në parlament dhe ai të kalonte e të aprovohej.

Për mua reagimi i Presidentit është në vazhden e avazit të tij politik për t'iu kundërvënë institucioneve të shtetit, duke përfshirë Këshillin e Ministrave apo qeverinë. Ai ka një qasje partiake, nuk është President i Republikës në shumë qasje që ndërmer ndaj zhvillimeve legislative, por ka një qasje partiake dhe më shumë duket sikur është kryetari i LSI-së sesa Presidenti i Republikës, më shumë kryetar i LSI-së sesa komandant i Forcave të Armatosura, siç e parashikon Kushtetuta. E ka shkelur Kushtetutën haptazi, duke iu arratisur pozicionit të unitetit kombëtar, të cilin ia detyron Kushtetuta që ta interpretojë.

Sigurisht, në dokumentin që ka sjellë, nëse ka një pikë, e cila mund të hajë një lloj diskutimi, është çështja e nivelit arsimor për të rekrutuar ushtarakë në gradën më të ulët që kanë Forcat tona të Armatosura. Sigurisht, kjo është e parashikuar për detyra të thjeshta që mund të ketë kjo kategori grade në Forcat tona të Armatosura dhe nuk cenon aspak të gjithë procesin e karrierës dhe të gradave në nivele të tjera. Pra, e gjithë retorika, që u interpretua edhe tani lidhur

me çështjet dhe shqetësimet për sa i përket arsimit dhe karrierën në gradë të ushtarakëve, nuk qëndron. E vetnja gjë që qëndron është që ne si qeveri, si shtet dhe ligjvënësi në fund të pranojmë që për detyra të thjeshta dhe jo të komplikuar, që nuk kanë lidhje me ndërveprueshmërinë, me forcat e tjera të NATO-s të pranojmë të vijmë ushtarë me arsimin 9-vjeçar. Sigurisht, që kjo është një çështje që mund të hajë diskutim, por që nuk lë hapësirë për të mbajtur fjalime politike kaq të gjata, që janë thjesht një fushatë elektorale.

Për sa u përket çështjeve të tjera, ligji është konsultuar me të gjitha strukturat e Forcave tona të Armatosura dhe, siç e theksova, është mirëpritur përmbajtja e këtij ligji, pasi sjell shumë përfitime për karrierën e ushtarakëve tanë në Forcat tona të Armatosura dhe nuk ka asnjë diskutim tjetër lidhur me çështje specifike, për të cilat Presidenti është munduar që të gjejë “argumente” për të kthyer ligjin në Kuvend, pra për të mos e dekretuar ligjin. Unë për sa u përket argumenteve juridike, do t’ia lë fjalën drejtorit të Drejtorisë Juridike, po e quaj kështu këtë drejtori më thjeshtë, për të mos e përmendur të gjithë tërësinë e emrit, siç është përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, sepse ato janë çështje specifike. Në fakt, janë të thjeshta, por mendoj që është më e udhës që fjalën ta marrë zoti Shehu. Pastaj, ju kërkoi leje të largohem nga mbledhja, sepse jam i angazhuar në takime të tjera.

Dua të them edhe një gjë, dua të përshëndes gjeneral Prengën, i cili është prezent në këtë lidhje, gjithashtu edhe ju anëtarë dhe ju anëtare të Komisionit të Sigurisë Kombëtare, veçanërisht ju, zonja kryetare!

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Koçi!

Edhe ne ju urojmë punë të mbarë!

Përpara se t’ia jap fjalën zotit Shehu, ne, si Komision i Sigurisë Kombëtare, jo vetëm për faktin që ishim dhe jemi komision përgjegjës për çfarëdo ligji që propozohet apo ndryshohet që, natyrisht impakton, Forcat e Armatosura, ne i kemi kushtuar rëndësi, sepse kemi bërë disa mbledhje për këtë projekt. Pra, nuk është një projekt që ka kaluar për një mbledhje të vetme. Ne kemi pasur diskutimet tona me përfaqësuesit e Ministrisë së Mbrojtjes dhe kemi kërkuar që grupi i punës së përbashkët, pra përfaqësuesit e Komisionit të Sigurisë Kombëtare dhe të Ministrisë së Mbrojtjes, të diskutonim për disa dispozita të propozuara për mirëmbajtjen më të duhur të tyre. Pra, di të them që qasja jonë ka qenë e lidhur totalisht me përgjegjësi që ne kemi dhe që ne dimë përkundrejt Forcave të Armatosura, në rast se diskutojmë ligje që lidhen me to.

Edhe çështja e arsimit, që është bërë pjesë e debatit në dekretin e Presidentit të Republikës, ka qenë një çështje që është diskutuar në Komisionin e Sigurisë, janë dhënë argumente dhe në fund ka fituar argumenti pro.

Për më tepër, të mos harrojmë që një pjesë e mirë e anëtarëve të këtij komisioni kanë *background* ushtarak, prandaj edhe diskutimi ka qenë i lidhur drejtpërdrejt me interesa të një arsimimi apo të një përvoje të mëparshme në Forcat e Armatosura.

Zoti Shehu, ju lutem na bëni një përmbledhje, që të mund t'ia lëmë edhe fjalën relatores, pra cilat janë argumentet tuaja kundër argumenteve që sjell Presidenti në dekret.

Ismail Shehu – Faleminderit!

E nderuara kryetare,

Të nderuar anëtarë,

Të nderuar përfaqësues të Presidencës,

Unë po filloj me aspektet teknike të dekretit të Presidentit të Republikës, të cilat përmbledhen në 5 pika kryesore.

Pika e parë e dekretit, e ngritur nga zoti Dervishaj, ishte çështja e moskonsultimit dhe e mosthëllimit në hartimin e këtij ligji, dua t'i bëj të qartë komisionit që hartimi i këtij ligji ka nisur që në mars të vitit 2019, pra është punuar 2 vjet me këtë ligj dhe është detajuar, diskutuar dhe rakorduar pothuajse në çdo aspekt i këtij projektligji. Për më tepër, në aspektin ligjor detyrimi për konsultimin publik është 30 ditë, dhe e ka mbajtur të paktën 3 muaj të afishuar, qoftë në portalin e konsultimeve publike, qoftë në faqen e vet *online*. E mbi të gjitha, ajo që është thelbi i çështjes, konsultimi publik nënkupton konsultim publik, në radhë të parë, me grupet e interesit. Nëse ka një grup interesi për ligjin mbi gradat dhe karrierën e forcave të armatosura, janë pikërisht ushtarakët e Forcave të Armatosura. Ky projektligj jo vetëm që është konsultuar, por është hartuar nga ky “grup interesi”. Praktikisht edhe në grupin e punës, të ngritur nga ministri i Mbrojtjes i kohës, produkti është hartuar nga Shtabi i Përgjithshëm, Forcat Tokësore, Forcat Ajrore, Komanda Mbështetëse, ish-Komanda e Doktrinës së Stërvitjes, Qendra e Personelit të Rekrutimit, Drejtoria e Personelit dhe Drejtoria Juridike. Pra, praktikisht mbi 80% e përbërjes së grupit të punës kanë qenë vetë ushtarakët apo përfaqësuesit e grupeve ushtarake të Forcave të Armatosura. Ky ligj jo vetëm që është konsultuar, por e ka tejkaluar me shumëfish këtë proces. Pra, është hartuar bashkërisht kryesisht nga vetë strukturat e Forcave të Armatosura, që janë subjekte të drejtpërdrejta të këtij projektligji. Në këtë kuptim besoj se ky argument bie dhe nuk ka asnjë bazë reale se ku do të mbështetet.

Për sa i përket pikës së dytë, që ishte dhe më e debatuar, ishte çështja që Presidenti ngre pretendimin se nëpërmjet ndryshimit të një neni specifik të ligjit aktual ne po ulim nivelin

e rekrutimit të ushtarakëve në Forcat e Armatosura. Për të gjithë anëtarët e komisionit, besoj se e keni të qartë që ushtarakët i ndajmë në tre kategori: oficer, nënoficer dhe ushtarë. Ne po flasim për ndryshimin, për uljen e kriterit minimal të rekrutimit për kategorinë e ushtarëve. Kini parasysh që ky është përjashtimi nga rregulli, pra nuk është rregulli që tani ushtria do të fillojë të punësojë vetëm personel me 9-vjeçare. Jo, bëhet fjalë, ne e kemi sqaruar në mënyrë ezauruese edhe në relacionin e projektligji, për të rekrutuar për detyrat jokomplekse, ku është pothuajse e pamundur të gjejmë persona me kriterin arsimor të shkollës së mesme. Mund t'ju jap edhe shembuj specifikë, bëhet fjalë për ruajtjen e pikave të vrojtimit, për ruajtjen e radarëve apo antenave apo për magazina dhe objekte ushtarake në zona të izoluara larg vendbanimeve, larg vendqëndrimeve, ku ka qytete fshatra e të tjera. Në këto zona jo vetëm këtë vit, por në vijimësi ka pasur gjithmonë probleme rekrutimi, pasi është ekstremisht e vështirë që të gjejmë një person me shkollë të mesme, i cili të marrë përsipër shërbimin e ruajtjes së një pike vrojtimi një javë rresht e të tjerë. Pra, për këtë kategori subjektsh bëhet fjalë. Pra kriteri i arsimimit 9-vjeçar është një përjashtim nga rregulli. Aplikohet vetëm për këto pozicione, nuk është ky rregulli. Pra, rregulli do të jetë i përgjithshmi, që ne do të kërkojmë të jenë me shkollë të lartë. I marrim me shkollë të lartë. Nëse nuk gjejmë me shkollë të lartë në pjesën kryesore, do t'i marrim me shkollë të mesme. Arsimi 9-vjeçar do të jetë vetëm për detyra shumë të veçanta, jokomplekse, në zona të izoluara larg vendbanimeve.

Kjo ishte ideja dhe nuk besoj të ketë problem. Ky problem është analizuar ndër vite, para vitit 2019, sepse në vijimësi kemi pasur, dhe besoj se gjenerali është në dijeni, pasi ka qenë në drejtim të Forcave të Armatosura për disa vite, që rekrutimi për këtë pozicion është jashtë mase i vështirë. Arsyeja ka qenë realisht për të plotësuar një gap që ekziston në terren. Besoj se ky ndryshim e plotëson këtë mangësi.

Për sa i përket argumentit të tretë të Presidentit, që pretendohet se ne kemi hequr një nga kriteret e përparimit në gradë, që është dhe arsimimi, nuk është aspak e vërtetë.

Nuk kemi merak në vetvete nëse do ta lëmë në ligj apo do ta bëjmë me urdhër të ministrit.

E para, ne nuk e kemi hequr kriterin e arsimimit, pasi dispozita vazhdon të jetë “arsimim në Forcat e Armatosura”.

Kriteret janë: grada që mban, vlerësimi vjetor, koha minimale e qëndrimit dhe arsimimi.

Arsimimi vazhdon të jetë, por emërtesa e kurseve, që kërkon secila gradë, për të marrë gradën e radhës, janë hequr nga ligji dhe është kaluar për t'u miratuar me urdhër ministri. Pse? Sepse vetë ligji i pushteteve ka një dispozitë specifike, ku thuhet: “Politikat e arsimimit i miraton Ministri i Mbrojtjes me urdhër” dhe është parë e arsyeshme që në politikën e arsimimit

të jenë edhe këto kritere, emërtesat e kurseve, që do të zhvillojë çdo oficer për marrjen e gradës së radhës. Pra, nuk bëhet fjalë për zhdukje kriteri, përkundrazi, është menduar që, edhe për fleksibitet, për ta përshtatur edhe me zhvillimet e reja, me mbylljen e ish-KDS-së dhe me krijimin e Akademisë së Forcave të Armatosura, emërtesat e këtyre kurseve t'i vendosim në dokumentin e politikave të arsimit.

Për sa i përket argumentit të katërt të Presidentit të Republikës, i cili kishte të bënte me heqjen e specialiteteve, dua që komisioni dhe përfaqësuesit e Presidencës ta kenë të qartë se nuk po flasim për specialitete të forcave ajrore detare, tokësore e të tjera, por flasim për specialitete në kuptimin e të qenit mjek, instrumentist, inxhinier, IT, e të tjerë. Pra, për këto natyra specialitetesh. Aktualisht në ligj janë përcaktuar vetëm mjekësia dhe orkestra frymore e Forcave të Armatosura praktikisht.

Ermonela Felaj – Zoti Shehu, kemi një shkëputje me ju.

Ismail Shehu – Ju kërkoi ndjesë kryetare, ishte një problem teknik.

Isha te pika e katërt e Presidentit.

Në këtë rast, duke marrë parasysh zhvillimet e reja, duke marrë parasysh krijimin e Akademisë së Forcave të Armatosura, duke marrë parasysh edhe nevojat, që janë në vijimësi, për shembull, nëse para 10 vjetësh kishte nevojë për 5 veta personel në specialitetin IT-së, sot mund të kemi nevojë për 100, është parë e udhës që ne nuk mund të rishikojmë ligjin vit pas viti, duke shtuar apo hequr kritere specialitetesh dhe, në këtë mënyrë, këto specialitete të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Argumenti i fundit i ngritur nga Presidenti i Republikës në dekretin e tij kishte të bënte me emërimin e oficerëve në një funksion organik më të ulët.

Kjo është diçka që ndodh rëndom në Forcat e Armatosura dhe jo me punë qejfesh të “x” apo “y” drejtuesi, por për shkak të plotësimit të mungesave në funksione të caktuara. Është më se normale, është operuar në vijimësi në këtë formë; bëhet fjalë për emërimin në një funksion të një grade më të ulët, pra jo tejkalim, siç është diskutuar në dekretin e Presidentit, por ne thjesht kemi bërë një rregullim të asaj dispozite. Pëlqimi do të jetë. Pra, pas një viti, nëse kërkohet të shërbehet sërish në atë funksion, do të kërkohet pëlqimi i vetë ushtarakut. Këtu duhet të kemi parasysh se dispozita është hartuar në atë formë duke marrë parasysh edhe detyrimin që ka çdo ushtarak për të shërbyer në pozicionin që i kërkohet për të shërbyer.

E dyta, në asnjë rast nuk cenohet karriera, puna, privilegjet e forcave ushtarake, pasi emërimi në një detyrë që ka gradë më të ulët, nuk nënkupton as ulje në gradë, as ulje në përgjegjësi, apo vonesa në emërimet e të tjera. Pra, bëhet fjalë për plotësimin e nevojave organike të caktuara, kur nuk gjen një person tjetër në atë gradë, të çosh dikë tjetër me minus

apo plus një gradë në atë vend. Paga është e njëjtë, vjetërsia është e njëjtë dhe mundësia e përparimit në karrierë është e njëjtë. Në këtë aspekt nuk cenohet asnjë e drejtë e ushtarakut të Forcave të Armatosura.

Këto pika ishin për aspektin teknik.

Për çdo pyetje tjetër, jam i gatshëm.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Shehu!

Ju i përmblohdhët argumentet një për një.

Zonja Dhima, keni diçka tjetër për të shtuar, që të mos përsërisim të njëjtat gjëra?

Antoneta Dhima – Faleminderit, zonja kryetare!

E falënderoj zëvendësministrin Koçi, zotin Shehu për prezantimin e kundërargumenteve, si dhe zotin Dervishaj!

Si në shumicën e rasteve, me projektligjet e tjera që janë kthyer për rishqyrtim në Kuvend nga Presidenti, edhe me ligjin nr. 15/2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, nuk kishte si të ndodhte ndryshe. Në fakt, ne kemi diskutuar si komision këtë projektligj dhe diskutimi, që kemi bërë, ka qenë për faktin se ai do të garantojë përmirësime të dukshme në drejtim të funksionimit të FA-së, duke përmirësuar kështu aspekte të rëndësishme të karrierës ushtarake, siç janë pjesa e rekrutimit, koha e qëndrimit në secilën gradë, mosha maksimale e shërbimit për çdo gradë, specialitetet dhe arsimimi i detyrueshëm. Në fakt, kundërargumentet u thanë shumë qartë nga zoti Shehu dhe do të thosha që diskutimi i këtij projektligji është bërë nga një grup pune, i përbërë nga persona të cilët janë pjesë e administratës dhe pjesë e institucionit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe mendoj që Presidenti, ose përfaqësuesi i Presidentit nuk mund të bënte asgjë ndryshe nga përfaqësuesit, që kanë qenë pjesë e grupit të punës, i cili është ngritur me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes. Ne e kemi diskutuar këtë projektligj, e kemi miratuar në seancë plenare dhe ndryshimet e bëra në këtë ligj synojnë rritjen e meritokracisë, barazisë dhe efektivitetit të FA-së në Republikën e Shqipërisë dhe unë si ish-ushtarake e kam thënë dhe e them prapë, sepse kam punuar afërsisht 12 vjet në FA dhe në respekt të përkushtimit, të angazhimit të të gjitha atyre grave dhe burrave, që shërbejnë aktualisht me devotshmëri në FA të Republikës së Shqipërisë, si dhe gjatë kohës që ne e diskutuam dhe e miratuam ligjin, kemi marrë vlerësime nga pjesa e këtyre strukturave për miratimin e këtij ligji.

Prandaj do t’i ftoj të gjithë kolegët deputetë që të votojmë kundër këtij dekreti. Meqenëse kjo mbledhje është e fundit për Komisionin e Sigurisë Kombëtare u uroj të gjithë kolegëve suksese!

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Dhima!

Fjala është për kolegët e Komisionit të Sigurisë.

Kush ka pyetje në lidhje me qëndrimet, argumentet dhe kundërargumentet, që u sollën deri tani në këtë mbledhje nga përfaqësuesit e institucionit të Presidentit të Republikës dhe nga përfaqësuesit e Ministrisë së Mbrojtjes.

Ded Prenga - Zonja kryetare, kam diçka për të shtuar.

Ermonela Felaj – Po, zoti Prenga.

Ded Prenga – Faleminderit, zonja kryetare!

Zonja dhe zotërinj të Komisionit Parlamentar për Sigurinë Kombëtare,

Të ftuar të tjerë,

Unë si këshilltar i Presidentit për problemet e mbrojtjes ligjin e miratuar dhe të diskutuar e kam parë me shumë vëmendje dhe do të doja të shtoja disa gjëra që lidhen drejtpërdrejt me atë për të cilat ju jeni mbledhur sot në respekt të zbatimit të ligjit dhe në respekt të atyre për të cilat zëvendësministri foli si një politikan, zonja Dhima si politikane, dhe qëndrimi i saj tashmë dihet, zoti Shehu...

Ermonela Felaj – Të gjithë politikanë jemi këtu, edhe deputetët edhe përfaqësuesit e ministrisë, nuk kemi ndonjë cilësi tjetër, kështu që lërin disa argumente, ju lutem, sepse për ndryshe do të më duhet të ndjek rregullin e mbledhjes.

Ded Prenga – Dakord.

Kurse zoti Shehu dha vetëm opinionin e tij dhe nuk foli në aspektin juridik të trajtimit të problemeve. Unë do të doja vetëm që në një forcë të armatosur, ku raporti i ushtarit profesionist është i barabartë me raportin e oficerëve në FA, si rrallë në forcat e armatosura të ndonjë një vendi, kërkohet që niveli i arsimimit të mos jetë më i mesëm, parauniversitar, por të jetë me 9-vjeçar. Që në vitin 1986, zonja kryetare dhe ju të nderuar zonja dhe zotërinj të komisionit Pralamentar të Sigurisë, ka qenë i detyrueshëm rekrutimi i ushtarëve me arsim të mesëm. Në FA ata që kanë qenë pa arsim të mesëm, megjithëse kanë pasur karrierë jo të shkurtër brenda FA-së, janë përjashtuar dhe sot nuk e di në cilin vend e keni parë dhe keni eksperiencën, apo keni dëgjuar që rritet niveli i ndërveprueshmërisë me aleatët dhe vendet partnere dhe mike, duke ulur nivelin e arsimimit dhe për rrjedhojë edhe të kualifikimit. Zoti Shehu nuk përcaktoi dhe nuk e ka përfshirë fare në ligj. A ka përqindje të këtyre ushtarëve, që me të drejtë kërkohet të ruhen pikat e ndryshme të shpërndara në çdo cep të Republikës kur FA-ja ishte 100 mijëshe? Pse nuk është vendosur në ligj 10, apo 20 përqindëshi i atyre ushtarëve që ju duhen, por është lënë thjesht dhe vetëm niveli i rekrutimit me arsim të mesëm? Kujt i lind e drejta me ligj të ndërpresë në mes karrierën e një ushtaraku për t'u bërë nënoficer

në FA, kur ai ligjin që keni në duar dhe diskutoni e ka të përcaktuar qartë dhe prerë që nënoficer titullohet vetëm ushtaraku që ka përfunduar arsimin parauniversitar? Këtë të drejtë ju doni t'ia hiqni me ligj. A e dini ju zonja dhe zotërinj të Komisionit Parlamentar të Sigurisë që këta rekrutë, djem të rinj, të cilët dalin në moshën më të mirë të mbushur në FA nuk kanë asnjë mundësi për t'u integruar në shoqërinë civile dhe do të jenë një kontingjent i mirëpërgatitur për t'iu bashkuar strukturave terroriste dhe kriminale në vend? Këtë nuk e ka menduar asnjë. Pra, duhet ta mendoni më mirë! Unë nuk dua t'ju mbaj leksion, por më thoni nëse është kështu, atëherë unë do të isha dakord me institucionin e Presidentit. Hapeni ligjin dhe lexojeni!

Si është e mundur që brenda një ligji ka dy nene që bien në kundërshtim me njëra-tjetrën? Kryeministri ka të drejtë me propozim të ministrit të nxjerrë me rezervë ushtarakët me gradë madhore, kur ata janë nomenklaturë e drejtpërdrejtë e Presidentit të Republikës dhe Komandantit të Përgjithshëm të FA-së. Keni raste plot jo një me grada madhore në FA, që janë nxjerrë nga Kryeministri për mosbindje me propozim të ministrit dhe vazhdojnë të paangazhuar në një kohë kur ata dalin me dekret të Presidentit të Republikës. Shikojeni nenin përkatës, ku thuhet se kush e ka të drejtën t'i nxjerrë gradat madhore në rezervë e në lirim. Pra, gradat madhore u jepen oficerëve me dekretin e Presidentit dhe po ai ka të drejtë dhe kompetencë t'i nxjerrë, ndërsa ju, të nderuara zonja dhe zotërinj të Komisionit parlamentar të Sigurisë, diskutoni një ligj, ku i nderuar Petro Koçi, për të cilin kam respekt si person, flet si politikan e aq më keq edhe i nderuari drejtues i Drejtorisë Juridike të Ministrisë së Mbrojtjes.

Ku është grupi i interesit të ushtarakëve që ka diskutuar për këto probleme? Nuk është marrë fare në konsideratë, se unë kam mbi 38 vjet në Forcat e Armatosura dhe e di mirë se si është implementuar ligji nr.59/2014 në Forcat e Armatosura dhe, në qoftë se gjatë implementimit për 6 vjet rresht kanë dalë probleme, atëherë le t'i korrigjojmë dhe t'i përmirësojmë ato, jo t'i zhysim Forcat e Armatosura në atë pikë, ku, për fatin e keq të përbashkët tuajin dhe tonin, Forcat e Armatosura sot kanë mbi 20% të trupës aktive të përgatitur, që paguhet nga taksapaguesit shqiptarë, që kërkojnë të largohen nga Forcat e Armatosura. Atëherë...

Ermonela Felaj - Ju lutem, zoti Prenga, përfundojeni fjalën tuaj!

Dedë Prenga - ...se nuk ka rekrutë...

Ermonela Felaj - Ju lutem, zoti Prenga! Unë edhe mund t'jua ndërpres fjalën. Kështu që përfundojeni.

Dedë Prenga - Prandaj ju them me bindje që është në nderin tuaj të miratonit...

Ermonela Felaj - Zoti Prenga, e drejtoj unë mbledhjen, nuk e drejtoni ju nga aty ku jeni. Mbledhja drejtohet sipas rregullave që përcakton Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë, të

cilën po jua bëjmë me dije, që, meqenëse është rasti, ta keni parasysh për herë tjetër, kur të jeni para një komisioni parlamentar, përfshirë dhe Komisionin e Sigurisë.

Në nenin 86 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë thuhet shprehimisht: "Dekreti për kthimin e ligjit për shqyrtim bëhet pjesë e rendit të ditës së mbledhjes më të parë. Komisioni përgjegjës e shqyrton dekretin vetëm për çështjet e paraqitura në arsyetimin për kthimin e ligjit nga Presidenti i Republikës". Nuk po diskutojmë këtu ligjin aktual "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura në Republikën e Shqipërisë"; po diskutojmë vetëm argumentet që ka ngritur Presidenti kundër disa ndryshimeve, që ne i kemi diskutuar dhe i kemi miratuar në Kuvendin e Shqipërisë. Ky është diskutimi.

Po kthehem prapë te ligji aktual, ku në nenin 6 të tij, "Titullimi dhe gradimi i ushtarëve aktivë", thuhet saktësisht: ""Ushtar/detar aktiv i Forcave të Armatosura" titullohet shtetasi shqiptar që ka kryer minimalisht arsimin parauniversitar brenda ose jashtë vendit, ka kryer kursin përkatës ushtarak të ushtarit dhe bën betimin ushtarak". Sot e gjithë ditën, kjo pikë e interpretuar nga çdo jurist, përfshin edhe ata që kanë bërë arsimin 9-vjeçar. Kjo nuk ka shqetësuar njeri dhe nuk e ka bërë njeri dramë, sepse kështu ka qenë dhe nuk ka ndonjë ndryshim kaq të madh sa për të thënë: "Po u bëka nami me ndryshimin e propozuar në ligj!".

Nga ana tjetër, arsimin 9-vjeçar e detyron Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe përtej kësaj nuk mund të shkohet. Ndërkohë, siç ka qenë ligji, e lejonte dhe arsimin 9-vjeçar.

Fjala për kolegët, nëse kanë pyetje.

Dedë Prenga - Më fal! Nëse mundem...

Ermonela Felaj - Ju lutem, se këtu nuk jemi për debat mes jush! Ju dëgjuam ju, dëgjuam dhe të tjerët, vendimi na takon neve.

Dedë Prenga - Interesi është për të pasur një ligj që të jetë... *(Nuk dëgjohet)*

Ermonela Felaj - Për të gjithë ata që na ndjekin, për të kuptuar se çfarë nënkupton arsimi parauniversitar, unë po i referohem ligjit nr.69 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", nenit 2, ku thuhet: "Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: "Arsimi parauniversitar" përfshin nivelet arsimore në kodet 0,1,2 dhe 3, sipas klasifikimit ndërkombëtar standard të arsimit, të miratuar nga Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s në sesionin e 29-të të saj në nëntor 1997, përkatësisht: "niveli me kodin 0", arsimi parashkollor; "niveli me kodin 1", arsimi fillor; "niveli me kodin 2", arsimi i mesëm i ulët; "niveli me kodin 3", arsimi i mesëm i lartë". Pra, po t'i referohesh këtij ligji, diskutimi del komplet ndryshe, sepse do të thotë që ishte e nevojshme të ndërhyhej në këtë dispozitë dhe të mos shkohej më poshtë nivelit 9-vjeçar.

Kolegë, a keni pyetje dhe diskutime? Nuk keni.

Atëherë, ju ftoj të gjithëve të shfaqeni me figurë për votimin e dekretit.

Ju lutem, zoti Qefalia, shfaquni me figurë!

Meqenëse kuorumi është i plotë për të votuar dekretin, ju ftoj në votimin e tij.

Kush është dakord me dekretin e Presidentit të Republikës nr.11981, datë 26.2.2021 "Për kthimin e ligjit nr.15/2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.59 "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndyshuar""? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Rrëzohet dekreti i Presidentit të Republikës për kthimin e ndryshimeve të propozuara në ligjin "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë".

Faleminderit, kolegë!

Faleminderit përfaqësuesve të ftuar në mbledhjen e sotme!

Ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA